

VENDIM
Nr.285, datë 6.4.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN “FAN S. NOLI”,
NË KORÇË, TË PRONËS NR.542, ME EMËRTIM “SHTABI I BRIGADËS SË
KËMBËSORISË” KORÇË, E CILA ËSHTË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515,
DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë, të pronës nr.542, me emërtim “Shtabi i brigadës së këmbësisë” në Korçë, e cila është në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për ta përdorur për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore dhe për forcimin e punës kërkimore- shkencore të universitetit “Fan S. Noli”, në Korçë.

2. Prona nr.542, me emërtim “Shtabi i brigadës së këmbësisë”, në Korçë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Dorëzimi i kësaj prone të bëhet pas transferimit të Komandës së Mbështetjes Rajonale, në Korçë dhe pas heqjes së materialeve e të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të magazinuara në këtë pronë.

4. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, i ndalohej të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim të tretët.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha